



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 27-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 31. 01. 2020, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Arif Miftari, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Avni Olluri, drejtor i DA

4. Bekim Shabani, drejtor i DEZH-së
5. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
6. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
7. Rasim Hasani, drejtor i DSHP
8. Imer Rustemi, drejtor i DI,
9. Elmaze Behluli, drejtoreshë e DKA-së
10. Anila Reçica, drejtoreshë e DRKS
11. Merita Bytyqi, drejtoreshë DSHMS
12. Islam Kaleshi, zyra ligjore
13. Gafur Hetemi, zyra pronoro juridike
14. Besart Troshupa, zyra e informimit
15. Kimete Jashanica, OSBE
16. Bestar Ibrahim, zyrtar i teknologjisë
17. Haki Avdiu, zyrtar i teknologjisë
18. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit, hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se kemi një anëtare të re në Kuvend është Xhyzide Rustemi e cila vije në vend të Anila Reçica Llugin, e cila në vazhdim lexoi deklaratën për betim pastaj kryesuesi i uroi suksese asambleistës si dhe drejtoreshave të posa emruara.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 27-të Kuvendit.
2. Informatë për punën e KKSB-së për vitin 2019.
3. Propozim Rregullorë mbi taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.
4. Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Meqë vërejtje nuk pati rreth rendit të ditës Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se me të gjitha votat prezente, kaloi rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Lulzim Rustemi, së pari ju uroj një vit të mbarë me shumë suksese po ashtu ju uroj drejtoreshave të reja për punën si dhe koleges asambleiste. Kam disa kërkesa; e para ka të bëjë me furnizimin me ujë të pijshëm në Komunën e Lipjanit, ku kisha kërku që drejtori i ujësjellësit të ketë ftesë zyrtare dhe të vijë të raportoj në Kuvend. Po ashtu edhe kompania "Pastrimit" është mirë të paktën një herë në javë të dal të pastroj rrugët e qytetit pasi që rrugët po janë me baltë. Kam edhe një kërkesë për Kryesuesin që kur komuna të promovoj projektet të ftohen edhe anëtarët e Kuvendit.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendi, zakonisht ne ftesat i bëjmë publike por të shohim herave tjera.

Ganimete Qeriqi, edhe unë ju uroj punë të mbarë koleges asambleiste dhe drejtoreshave. Deshta të ngris një shqetësim nga shtëpia e shëndetit ku krahas shumë dukurive negative siç janë korrupcioni, nepotizmi shqetësues mbetet mospërfillja dhe

keqtrajtimi i mantil bardhëve. Unë së bashku me kolegët e mi çdo ditë pengohemi fyhemi, kërcënohemi, filmohemi, nënçmohemi në vendin e punës. E sidomos tash në këtë kohën e teknologjisë ku secili po e merrë të drejtën të filmoj dhe të postoj në faqe të botës dhe po ju epë mundësinë të tjerëve që në emër të punëtorëve shëndetësorë me komentu me gjuhë denigruese, poshtruese e nënçmuese. Me këtë rast po dëmkoset institucioni shëndetësorë. Dhe kjo te punëtorët shëndetësorë po shkakton neveri dhe po detyrohen të lëshojnë vendin e punës të dalin jashtë shtetit. Po ashtu kam edhe një shqetësim për ta ngritur gjatë vizitave në teren po shohim raste me kushte të rënda ekonomike dhe është mirë të merren parasysh.

Albulena Kelmendi, kam dy çështje për t'i ngritur, e para ka të bëjë me braktisjen e mësimit nga ana e nxënësve në shkolla. Kërkoj nga DKA-ja një raport sa nxënëx e kanë braktisur shkollën dhe pse? Pyetja e dytë çerdhja e re kur do të filloj punën e sajë dhe punëtorët e ri a janë në listën e pagave.

Argjend Tasholli, edhe unë ju uroj punë të mbarë dhe suksese të tri drejtoreshave dhe koleges asambleiste. Kam disa shqetësime të qytetarëve për t'i ngritur; e para ka të bëjë te rruga e lumit në Gadime ku lumi po qëndron i mbyllur nga meturinat. Ku gypi i kanalizimit është prishur dhe derdhet në lum dhe gjatë stinës së verës kundërmon erëra. Po ashtu problem me kanalizim edhe ne fshatin Gllavicë te lagja Reçica si dhe në Dobrojë te lagja Publica të cilat nuk kanë kyçe në kanalizim. Po ashtu kemi edhe një kërkesë te rruga Shpella e mermerit të ketë mbrojtëse të rrugës afër lumit. Po ashtu e kam një pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë a do t'i bëjë funksionale dy AMF-të në Smallushë dhe Banullë apo do t'i lë në fatin e natyrës.

Alban Salihu, tha se si një adhurues i sportit jam i zhgënjyer me organizimet nga Komuna. Një organizim që është ndër vite është liga total në futboll të vogël ku kjo ngjarje bashkon futbollist më të mirë të Kosovës. Çka me shtyri të flas sot është basketbolli kur ekipi ynë garonte në super ligë të Kosovës të gjithë u gëzuam për këtë sukses madje sallat u mbushëshin me tifoz. Por nga takimet e fundit jam zhgënjyer shumë, jo vetëm me rezultatin, por si nuk kemi arritur të kemi basketbollist të tonë por shumicën amerikan apo nga vendet tjera.

Shkelzen Bislimi, kam një kërkesë për Drejtoratin e Shërbimeve Publike që të bëj një kërkesë në KEDS apo KESKO, për ndërrimin e rrjetit të rrymës në Gadime rruga Egzoti 99, prej shkollës deri te lagja Limani. Po ashtu kanalizimi në fshatin Gllavicë rruga "Abdurrahman Gashi" si dhe ndriçimi dhe trotuari në këtë fshat. Si dhe dy çështje rreth asfatimit të rrugës Bajram Gashi në Janjevë dhe rrugës "Rashit Mehmeti" në Konjuh.

Lumturije Bytyqi-Hasani, edhe unë ju uroj punë të mbarë dhe suksese tri drejtoreshave. Kam një pyetje për drejtorin e DSHP me sa e dijë unë ka qenë e planifikuar rregullimi i trotuarit në QKMF por nuk është prekur fare. Kërkoj me na sqaru se a është planifikua rregullimi i ati trotuari dhe parkingu.

Bashkim Budakova, edhe unë ju uroj vit të mbarë dhe suksese të gjithëve e në veqanti drejtoreshave dhe drejtorëve. Pyetja ime është në mbledhjen e 16-të të Kuvendit të Komunës të datës 28.02.2019 është marrë vendim për dhënien në shfrytëzim për varrezat e fshatit Rubovc, mirëpo kjo ende nuk po gjen zbatim kur dihet që kjo është e nevojshme për banorët e fshatit Rubovc.

Egzona Bytyqi, së pari ju uroj shëndet dhe suksese drejtoreshave të emëruara dhe koleges asambleiste. Kam për ta ngritur çështjen e mbeturinave medicinale të cilat janë të një forme të veçant dhe paraqesin burim të rrezikut si për shëndet publik ashtu edhe për mjedisin, andaj konsideroj që këto mbeturina duhet të menagjohen me një kujdes të veçant. Duke filluar nga krijimi e deri te vendi përfundimtarë qoftë deponim apo asgjësim. Kërkoj nga drejtoria përkatëse të reflektoj këtë problematikë.

Nehat Tërpeza, edhe unë ju uroj suksese koleges asambleiste dhe drejtoreshave. Kam një pyetje çfarë është duke ndodhur me parcelen kadastrale të cilën ju ka dhënë Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për ndërtimin e Xhamisë në rrugën Haxhi Kleçka.

Naim Jahiri, edhe unë ju uroj suksese drejtoreshave dhe koleges asambleiste. Kam pyetje deri ku kanë shku procedurat për emërtimin e rrugëve nëpër fshatra. Si dhe çfarë po ndodh në rrugën Sllovi – Dobratin, ku kanë ngecur punimet.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha fillimisht sipas përgjegjësisë ligjore ju njoftoj për ndryshimet të cilat janë 5 e për të cilat i falenderoj drejtorët e deritanishëm dhe të po sa zgjedhurve dhe ju uroj punë të mbarë. Ne kemi vendos që drejtoreshë për DKRS, të jetë Anila Reçica – Llugini, në DSHMS, Merita Bytyqi, në DKA Elmaze Behluli, ndërsa në SHP, Rasim Hasani, në DEZH Bekim Shabani.

Sa i përket punës së ujit të pijshëm pajtohna që të jetë prezent drejtori i ujësjellësit në seancën e ardhshme. Pastrimi i rrugëve edhe kjo është e drejtë edhe pse rrugët e qytetit pastrohen. Ndërsa sa i përket çerdhes së re është funksionale por kemi vetëm një problem nga KEDSI për mos dhënien e pëlqimit për kyqje.

Stafi i punëtorëve të çerdhes është i kompletuar ne do ta rrisim edhe numrin e nxënësve.

Braktisja e nxënësve nëpër shkolla nuk e kam statistiken por mundemi me bërë një evidentim.

Klubet e sportit e kemi ndihmuar por ato nuk janë institucion komunal por llogariten si OJQ. Ndërsa kemi pak donatorë të cilët po mundohen me e mbajt gjallë sportin.

Mbeturinat shëndetësore është një kompani që merret me këtë çështje. Çështjet të cilat janë të planifikuara në buxhet të gjitha do të përfundohen dhe ato i keni edhe në web faqe dhe mund t'i shihni. Sa i përket çështjes së pronës për varreza në Rubovc kemi një ankesë nga familja Tasholli dhe me një vendim ajo është pezluar. Ndërsa sa i përket ndarjes së pronës për Xhami nuk e dije por me siguri po presin ndonjë donatorë.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 27-të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes 26-të dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 26-të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Informatë për punën e KKSB-së për vitin 2019.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Nazim Gashit, drejtor i DE-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata .

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, tha se KKSBJ-a nuk paska dështu ende por qenka asaj rruge, po më vjen keq për anëtarët e KKSBJ-së të cilët janë pasiv e që do të duhej të ishin më aktiv dhe do të ishte mirë që të shikohet ky këshill dhe të vendosen anëtarët të cilët do të kishin vullnet për punë.

Ukë Kryeziu, deshta t'i ngris dy çshtje rreth sigurisë që ka të bëjë me çështjen e narkotikëve nëpër shkolla se sa është niveli i nxënësve nga niveli fillor që janë përball me organet e sigurisë.

Çështja e dytë është grabitja nëpër fshatra ku më herët ka qenë fshati Smallush tani përball me këtë edhe fshati Sillovi. Kërkojmë nga Kryetari por edhe nga Komandanti i policisë që të rritet numri i patrollimeve për këto raste të cilat po ndodhin.

Nehat Tërpeza, kur thuhet te mungesa e takimeve të KKSBJ-së me anëtarët e KKSBJ-së të komunave fqinje, si mund të shkëmbejnë përvoja me të tjerët kur të tillët nuk diskutojnë asnjëherë në ato mbledhje.

Lulzim Rrustemi, është një informatë jo e mjaftueshme, ka pak angazhime të anëtarëve të KKSBJ-së, raporti bëhet vetëm prej një personi, nuk ka bashkëpunim rreth planit të veprimit, nuk ka bashkëpunim rreth projekteve. Nga ky këshill nuk ka ardhur asnjëherë kërkesë nga KKSBJ-a e të cilën të ia ketë refuzuar Kuvendi.

KKSBJ-a duhet të jetë më aktive ose duhet të ndërrohen anëtarët pasi që ky raport i këshillit mbërrin në OKB dhe duhet të ketë vigjilencë dhe përgjegjësi nga anëtarët.

Arben Salihu, edhe unë i bashkangjitem urimit për drejtoreshat e reja dhe asambleisten e re dhe ju uroj punë të mbarë. Kam dy çështje për t'i ngritur e para a ka pasur ndonjë plan KKSBJ-a për çështjen e trajtimit të narkotikëve, dhe çështja e dytë për siguri në trafik a është diskutuar ndonjëherë dhe a është ndërmarrë diçka për këtë çështje.

Afrim Miftari, edhe unë ju uroj punë të mbarë koleges asambleiste dhe drejtoreshave. Një informatë edhe pse jo e pëlqyeshme nga ana jonë por një informatë reale. Janë paraqitur disa formulime ku në faqen 2 ceket se janë paraqitur disa kërcënime. Cilat kanë qenë ato kërcënime? Ndërsa sa i përket çështjes së buxhetit anëtarët e Kuvendit është dashtë me qenë më vegjilent me kërkesat e tyre drejtuar Kuvendit. Është mirë që të shikohet edhe njëherë puna e këtij këshilli pasi që po shihet që ka pasivitet.

Nazim Gashi, anëtarët janë pasiv por këtë vërejtje duhet ta jep komuniteti i cili ka dërguar dhe është përgjegjësi individuale e secilit anëtarë i KKSBJ-së nëse don të jetë aktiv ose jo. Përfaqësuesi i policisë në KKSBJ e diskuton rreth raportit por në këtë këshill nuk nxirren statistika. Por vetëm bën rekomandime në institucionin përkatës.

Albulena Kelmendi, në seancën e fundit kemi kërku që të kemi një raport për statistikat e narkotikëve në Komunën e Lipjanit mirëpo deri më tani nuk ka ardhur. Kërkoj që në sencat e ardhshme që të kemi një raport të tillë.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se para pak dite policia e Kosovës ka pasur një raport këtu në sallën e kuvendit ku kam qenë prezent unë dhe disa drejtor dhe mua më është dhënë një kopje e raportit. Andaj raporti i Policisë është publik mundeni me pa.

Me që diskutime të tjera rreth kësaj pike nuk pati, u kalua në pikën e tretë të rendit të ditës.

III

Propozim Rregullore mbi taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Emina Rexhiqit, drejtoreshë e DPU-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, kam pyetje a ka fillu me u zbatu kjo Rregullore dhe taksat administrative. Pyetja e dytë te neni 9-të te taksat dhe tarifet duhet të jetë edhe familjet e martirëve.

Hyra Bytyçi, edhe unë ju uroj punë të mbarë drejtoreshave të reja dhe koleges asambleiste. Ne si grup parlamentar i LDK-së e mbështesim propozim Rregulloren mbi taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

Emina Rexhiq, Rregullorja është zbatuar pajtohem me Lulin që të jetë edhe familjet e martirëve.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 27 votat për, aprovoi këtë:

Rregullore mbi taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

IV

Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shefqet Amerllahut, drejtor i DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Daut Azemi, Kryesuesi i Kuvendit, tha se në KPF është ardh propozim nga Ukë Kryeziu i cili ka thënë se duhet të shtohet aty ku është fermer edhe ekonomitë familjare pasi që fermer konsiderohet ai që e ka certifikatën NIF-in.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, një vendim i mirë por nuk e dijë a po përfitojnë fermerët dhe apo ndahen në baza meritore dhe kjo sera prej 50m² nuk e dijë sa i nxit zhvillim ekonomik dhe do të ishte mirë që të jenë 100m².

Nazmi Krasniqi, kam një pyetje a ka ndonjë raport nga viti i kaluar për rastet të cilat janë ndihmuar por nëse ka edhe ndonjë rast që janë keqpërdor subvencionet nëse nuk ka është mirë që në seancat e ardhshme të ketë.

Ukë Kryeziu, unë edhe në KPF e kam ngritur çështjen që të jetë ekonomitë familjare dhe fermerët po ashtu e kam ngritur çështjen që subvencionet e komunës të cilat i ndanë Komuna ta kenë edhe llogon e saj dhe në cilin vit kanë qenë përfitues.

Majlinda Sylejmani, ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim, po ashtu e përkrahim edhe propozimin për ndryshim të cilin e tha drejtori.

Egzona Bytyqi, unë personalisht e përkrahi çdo propozim vendim për ndarjen financiare si masë stimuluese për fermer, por edhe që e rritë prodhimtarinë falë të të hyrave bujqësore. Kisha pas dëshirë që mjetet për bujqësi me u rritë e ndoshta edhe me u dyfishu.

Alban Salihu, edhe ne e përkrahim këtë propozim vendim por shpresojmë që ndarja të bëhet në bazë të kriterëve.

Afrim Miftari, edhe ne si grup e përkrahim këtë propozim vendim si dhe e përkrahim edhe propozimin të cilin e dha drejtori fermer dhe ekonomi familjare.

Lulzim Rustemi, ne jemi për përkrahje të bujqësisë e të fermerëve në veçanti por ne jemi marrë vesh edhe vitin e kaluar që të ketë një raport detal për çdo subvencion të ndarë të shohim se a po ka rutinë apo po shkojnë mjetet aty ku duhet. Duhet të shihet se me ato mjete a po ndihmohen apo duhet të ndryshohet ajo formë e ndarjes së mjeteve. Kërkojmë që të ketë një raport detal për të gjithë përfituesit po ashtu të ketë raport se si janë shfrytëzuar ato subvencione.

Shefqet Amerllahu, komisioni i cili i ka nda subvencionet po i njëjti komision edhe i mbikëqyr. Ne vitin e kaluar kemi marrë informata se një fermer ka keqpërdorur mjetin e fituar nga Komuna dhe unë sëbashku me komisionin dhe policinë kemi dalur dhe kemi konfiskuar atë multikultivator. Nga viti i kaluar na kanë tepruar afër 390 euro. Pajtohem që të jetë për fermer dhe ekonomi familjare.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR
FERMERË DHE EKONOMI FAMILJARE

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare në shumë prej 95.000 €, për subvencionimin e fermerëve dhe ekonomive familjare të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

1. Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të subvencionimit dhe furnizimit të fermerëve dhe ekonomive familjare të Komunës së Lipjanit me serra në sipërfaqe prej 50m² dhe motokultivator si pas tabelës në vijim:

Numri i përfituesve	Çmimet
Serra në sipërfaqe prej 50 m ²	60,000 €
Motokultivator	35,000 €
Gjithsej	95.000 €

Neni 3

Procedurat e blerjes së serrave, dhe motokultivatoreve do të zhvillohen nëpërmjet procedurës së prokurimit publik

Neni 4

Mënyra e përzgjedhjes së përfituesve do të bëhet nëpërmjet shpalljes publike për aplikim në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019.

Neni 5

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2020.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 11,³⁵

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

